



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion
Mbledhja nr. 17/2010

Prishtinë më 27. 04. 2010, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

**I mbledhjes së Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport
dhe Telekomunikacion**

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani - kryetare, Ethem Çeku, Mursel Halililji,
Zef Morina, Qamile Morina, Múfera Şinik, Nerxhivane Dauti dhe Kaqusha Jashari.

Munguan: Sala Berisha – Shala dhe Fatmir Rexhepi.

Pjesëmarrës të tjerë: Dino Asanaj, kryetar, Shkelzen Lluka dhe Mrika Tahiri - AKP, Ali
Hamiti, kryetar i Bordit – ZRRE, Ruzhdi Shehu, Lebibe Haliti dhe Remzije Hajdari –
MTI, Haxhi Gashi –USAID, Besim Zeqiri – ICO, Lumnije Murati – ZPRK, Isuf Zejna –
KDI dhe Ibrahim Krasniqi - konsulent.

Stafi Mbështetës: Hasan Tahiri, Advije Morina, Armend Ademaj, Besim Haliti dhe
Nuriye Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Myzejene Selmani, kryetare.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d d i t e

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të 20. 04. 2010;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2009;
4. Shqyrtimi i Raportit vjetor i Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2009;
5. Shqyrtimi i Projektligjit për Inspektoratin e Tregut dhe Mbikëqyrjen Inspektuese
nr. L-181;
6. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 20. 04. 2010

Procesverbali i mbledhjes të 20. 04. 2010 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit – AKP për vitin 2009

Kryetarja - Tha se është ftuar kryetari i Bordit të AKP - së Dino Asanaj, që të raportojë para Komisionit për Raportin vjetor të AKP- së për vitin 2009.

Dino Asanaj (kryetar i Bordit të AKP - së) – Njoftoi se AKP - ja çdo tre muaj i dërgon Kryesisë së Kuvendit raport tremujor, ndërsa tani para Komisionit është hartuar raporti vjetor për vitin 2009, në të cilin është përfshirë i gjithë aktiviteti i vitit 2009, që ka të bëjë me privatizim dhe me monitorim, me përgatitjet e Komitetit të Likuidimit, me shpërndarjen 20%, me monitorimin e ndërmarrjeve të shitura me Spin-off special dhe njëherit vendimet e Bordit të komunikimit dhe të reagimeve të AKP- së për pronat që janë jashtë territorit të Kosovës.

Kryetarja ua dha fjalën deputetëve që t'i paraqesin pyetjet e tyre në lidhje me raportin vjetor të AKP - së.

Qamile Morina – Theksoi se Raporti teknikisht është i mirë. Një vërejtje ishte që nuk e kemi pasur shpjegimin për shkurtesat, se çka do të thonë ato. Duke e lexuar këtë raport shtrohet pyetja kujt i përgjigjet kjo Agjenci? Është e vërtetë që Agjencia i përgjigjet Kuvendit. Mirëpo nëse shikohet ky raport dhe nëse mendon se Kuvendi po e monitoron Agjencinë e Privatizimit, në një raport të tillë, me një mbikëqyrje substancionale të punës së saj, personalisht mendoj se shumë gabon. Raporti e ka një organogram shumë më të mirë, mirëpo mungon monitorimi. Edhe pse një mbikëqyrje, një audit, është bërë nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian, raportin nuk e kemi. Auditin e brendshëm, që ju e keni filluar, keni hasur në shumë probleme, të cilat ju mendoni se nuk i përmendni në raportin tuaj dhe sugjeroni se në vitin 2010 do t'i zbatoni ato mangësi që nuk keni mund t'i identifikoni gjatë auditit tuaj. Pastaj pyeti: Auditin që ka ndodhur, a ka ndodhur sipas Ligjit, auditin i jashtëm? A mendoni ju se do të ishte më mirë që Ligji, që e keni ju, që caktohet nga neni 25, në auditin e jashtëm, duke përfshirë edhe auditin financiar dhe auditin plotësues, për të cilët edhe Kuvendi mund të vendosë? A mendoni se do të ishte një punë e mirë, që Kuvendi ta ketë një pjesë të auditit? Sa është respektuar çështja e sigurimit të konkurrencës, sepse Vala 40, kemi 12 ndërmarrje shoqërore dhe 12 ndërmarrje të reja, kurse kemi ofertues 27, që do të thotë se çështja e sigurimit të konkurrencës është në dyshim edhe pse përfundimisht ju thoni që kemi 98 ndërmarrje të reja që janë tenderuar, kurse ne kemi pasur 334 ofertues. Kjo vetëm bie ndesh, se çdo ndërmarrje ka pasur mesatarisht tre ofertues. Pyetje e tretë do të ishte në raportin tuaj

trajtimi i formës së parcelave të tokës në zyre lokale kadastrare që kanë qenë të përfshira, a ka dhe sa ka ankesa në gjykata? A kanë rritje dhe cilat janë ato komuna? Pastaj kërkoi të shpjegohet çështja e 20%; çështja e ndërmarrjes shoqërore në Gjakovë, çështja e Trepçës, ku Bordi i Postës dhe Telekomit, i ofron 80 milionë euro, i ofron një veturë të markës “Mercedes”, pastaj edhe çështjen Gjykatës Supreme?

Kaqusha Jashari – Theksoi se ky raport ka shumë të dhëna dhe transparencë që mund të procedohet në Kuvend me ndonjë plotësim ose rekomandim që të jetë me i qartë. Pastaj e shtroi pyetjen: si është situata në Agjencinë dhe në Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme? Është momenti që duhet të fillojë një procedurë në Kuvend për plotësimin e Ligjit dhe pyeti se a ka mundësi të shihet a po funksionin Dhoma e Veçantë? Pyetja e dytë është lidhur me mjetet në bankë, ndërkohë a ka ndryshuar diçka dhe a keni marrë përgjigje dhe a është ende ajo situatë që e keni shpjeguar në opinion? Lidhur me ndërmarrjet e privatizuara me metodën spin - oof. Janë dhënë afatet kur duhet të plotësohen ato për investime dhe për punëtorë? Në fund pyeti si është gjendja e administrimit të drejtpërdrejtë? Fjala është për Pallatin e Rinisë.

Ethem Çeku – Theksoi se është një material i mirë, i pajisur me të dhëna që japin një pasqyrë të punës që është bërë në këtë Agjenci, edhe përkundër vështirësive që ballafaqohet. Ai shtoi se si çështje të hapura janë: ndërmarrjet e Gjakovës dhe çështja e dytë është spin- off special, si metodë a do të vazhdojë apo do të ndërkrehet? Duke apostrofuar ndërmarrjet SHAR – CEM - in, dhe FERRONIKEL - in, marrëveshjet që janë bërë në çështjet mjedisore, sepse Ministria e Mjedisit nuk ka potencial të vendosë edhe pse ligjet janë të fundit. Pastaj potencoi çështjen e Trepçës dhe e vlerësoi një problem të gjatë dhe të madh, si dhe kërkoi të sqarohet nga AKP- ja cilat janë politikat që kanë të bëjnë me kompleksin mineral të Trepçës. Cila do të ishte ndihmesa jonë që ne në Parlament ta shtyjme këtë proces, që ka të bëjë me Trepçën, edhe pse mendimi i tij ishte se ndërrimet që janë bërë në Trepçë nuk kanë sjellë asnjë efikasitet, asnjë progres, do të thotë largimi i ekspertëve, njerëzve eminentë, si dhe sjellja e njerëzve të rinj, kjo mund të mbetet vetëm çështje e politikave, të cilat mendoj se është gabuar në atë drejtim. Në fund theksoi se me iniciativën e kryetares është hapur çështja e hartimit të Ligjit për privatizimin e ndërmarrjeve publike, ku edhe me institucionet përkatëse duhet t'i harmonizojmë qëndrimet që të vendoset për baza ligjore edhe mbi baza ligjore dhe pastaj duhet të ecim të gjithë bashkë, po ashtu kërkoj sqarim në lidhje me çështjen e mjeteve të privatizimit që gjenden jashtë shtetit.

Zef Morina – Pyeti për çështjen e mjeteve të privatizimit, të cilat janë jashtë vendit dhe është shumë shqetësuese për atë që thuhet nga ju se nuk dihet ku janë. Ndërsa guvernatori thotë se duhet të dihet dhe për ato mjete, dihet rregullorja se duhet të ruhen dhe si duhet të përdoren ato. Nga ana tjetër, lind dyshimi, si qytetarë, edhe si njerëz kemi përgjegjësi, a është vërtet shqetësuese gjendja edhe si është situata? Në fund tha se çështja e ndërmarrjeve të Gjakovës duhet të shikohet shumë seriozisht.

Dino Hasanaj - U përgjigj në pyetjet e deputetëve, si në vijim: AKP në Ligjin 03/1 67 për herën e parë mbas 7 ose 8 vjetëve, si vitin e kaluar edhe në këtë vit vjen të raportojë për gjendjen dhe strategjinë. AKM - ja ka pasur një autoritet të imponuar me imunitet

diplomatik pa përgjegjësi dhe llogaridhënie, prandaj kemi një komitet të zgjedhur dhe kemi një llogaridhënie. Agjencia ka shumë pengesa, sidomos ato ligjore, rregulloret e UNMIK- ut dhe procesin e likuidimit. Oda e Veçantë nuk është funksionale në shërbim të Agjencisë, as në proces të privatizimit. Shkaku është se ka gjyqtarë ndërkombëtarë, është një gjyqtare vendore, kur ta shikojmë edhe ajo mungon. Kështu që janë 7 vendorë dhe 13 ndërkombëtarë. Oda e Veçantë, në bazë të Paketës së Ahtisaarit, parasheh 5 panele, tani janë të pranishëm vetëm ndërkombëtarët e nuk ka asnjë vendor. Ende nuk ka kaluar Ligji mbi Odën e Veçantë, i cili kishte për t'i rregulluar shumë gjëra. Për rastin e Trepçës, që është nën moratorium ka edhe 24 ndërmarrje, që janë asete thelbësore dhe sociale, të cilat nuk kanë të bëjnë asgjë me miniera. Mirëpo moratoriumi, si ombrellë, e ka përfshirë edhe atë. Ajo pengon në zhvillim ekonomik në ato qytete ku ndodhet kjo ndërmarrje, por njëherit zvogëlon vlerën e ndërmarrjes për shkak të elaborimit, do të thotë me vite duke u mbajtur nën moratorium ekziston Raporti financiar ose përshkrimin e Trepçës; është formuar një Komision i përbashkët me Ministrinë e Energjisë dhe janë bërë disa takime për strategjinë. Rekomandimi ynë është shumë i thjeshtë; asetet të cilat nuk kanë të bëjnë me miniera duhet privatizuar sa më shpejt, që të mos mbahen pengë, në vende se ku ndodhen këto asete, d.m.th. këto asete nuk kanë të bëjnë me miniera, as me Trepçën. E dyta është identifikimi i kreditorëve të vërtetë, mund të them se Trepça ka borxh rreth 100 milionë, ndërsa nga disa të tjerë thuhet 25 dhe kjo shumë shkon deri në 500 mijë. Aty mund të ketë manipulime me dokumentacion, mirëpo unë mendoj se duhet të identifikohen borxhlinjtë e vërtetë dhe të dihet sa është kjo shumë. Qeveria për financimin e Trepçës, duhet të bëhet kreditor ose pronar, do të thotë është duke u punuar në atë strategji. Janë bërë disa takime dhe me këto takime do të vazhdohet në të ardhmen. Mirëpo, për Trepçën, prej menaxhimit të ri, që është marrë përpara, ka qenë i rekomanduar një administrator ndërkombëtar. Unë mendoj se kështu nuk do të duhej të ndodhte, sepse strategjia ndërkombëtare ka qenë krejt ndryshe, të shkojë Trepça në likuidim dhe në këtë nuk e rekomandojmë. Ne rekomandojmë të bëhet ristrukturimi i Trepçës, të hiqen asetet, të cilat nuk kanë të bëjnë me minierën, të identifikohen kreditorët, pastaj të zhvillohet si proces, këtë e kam thënë për Trepçën. Kur u vendos moratoriumi për Trepçën është bërë me qëllim të mirë për ta mbrojtur Trepçën prej gjykatave jashtë territorit të Republikës së Kosovës. Gjersa ky moratorium ekziston, ne nuk mund as ta likuidojmë, as ta privatizojmë. Është e qartë se në bazë të Ligjit e rregullores 2005/48 ajo u krijua saktësisht për Trepçën, për ta mbrojtur prej kreditorëve. Aty parashihet edhe caktimi i administratorit të Trepçës dhe për ta administruar strategjia tani duhet të ndryshoj, pasi që tani i kemi institucionet tona vendore. Sa i përket Brezovicës AKP - ja ka zyra satelitore në tërë territorin e Kosovës. Ne e kemi zyrën në Leposaviq, e kemi privatizuar dhe kemi nënshkruar kontratë në veri. Ne e kemi zyrën në Graçanicë, që një vit, po ashtu kemi zyre edhe në Shtërpçë dhe ka filluar privatizimi edhe në enklava. Le të jetë shumë e qartë kjo, por duhet të kuptohet se Brezovica nuk është si një ndërmarrje shoqërore ose si një aset. Është master plani dhe është e planifikuar me Komisionin Evropian, me të cilin jemi në bisedime, që do të jetë edhe master plan i zonës turistike, që të shfrytëzohet maksimalisht 365 ditë, skijimi dimrit, ndërsa vrapimi verës dhe të ndahet zona e vilave dhe zona e hotelarisë, si dhe të rezervohet zona e skijimit të lartë për të sjellë investitorë të huaj. Te pyetja e konkurrencës, pse ka aq ofertues ose pse ka aq ndërmarrje tregu e dikton. Ne nuk mund t'i sjellim me dhunë. Ne e qesim Valën me 10 ndërmarrje, mund të lajmërohen 5 vetë. Mirëpo mund të lajmërohen edhe 50 vetë,

tregu është interesimi i asetit në bazë të atraktivitetit. Mirëpo çka ka ndryshim në mes të AKM - së dhe AKP – së? Ndryshimi është se ne shumë rrallë, me një ofertë nuk aprovojmë dhe kemi bërë ndryshim se përpara ofertuesi i parë është tërhequr, ofertuesi i dytë është tërhequr, ofertuesi i tretë ka fituar. Ne këtë e kemi eliminuar, sepse çmimi i parë gjithmonë fiton, e ky është ndryshimi, çka do të thotë se vlerën e ka caktuar tregu, sepse kur ka dalë në shitje, është ofertuar. Kjo është vlera që e ka caktua tregu e ne e ruajmë vlerën; pyetja tjetër ishte lidhur me auditimin. Auditimi i cili ka ndodhur nga Komisioni Evropian ndodh të jetë i vetmi donator. Ne e kemi vetëm një donator, auditimi i Komisionit Evropian është auditim mbi performancën, ju njoftoj se është Agjenci e vetme nga i cili pagat financohen nga ai dhe për ta ruajtur kualitetin e punës për ngritjen e kontrollit të punës të Agjencisë. Në pyetjen e ndërmarrjeve të spin off special kuptohet që të gjithë spin off specialë, që kanë qenë gjithsej 24, dhe spinofi special si metodë ishte i dështuar. Ky është konkluzioni im, si metodë nuk ka funksionuar, sepse metoda e spin offit special është i dizajnuar për punësim. Ndërmarrjet më parë në Kosovë kanë punësuar, sepse e kanë pasur një treg prej 20 milionë eurosh. Tani tregu Kosovar është 2 milionë euro, spin - off special që ka pasur sukses, ata të cilët e kanë pasur tregun, si shembull e marrim Birrën e Pejës, që e ka pasur tregun 90 %, dhe Ferronikeli i ka dyfishuar investimet dhe punësimin e ka mbajtur dhe është i liruar, nuk ka detyrime ndaj Agjencisë, ndërsa sa i përket mjedisit janë edhe ministritë, të cilat janë të obliguara, është edhe komuna e Drenasit. Kur është fjala për Feronikelin; në pyetjen për dhjetë ndërmarrje të komercializuara, është tregu, ai i cili do ta përcaktojë çmimin. Llamkosi tani është në shitje. Për ndërmarrjet e Gjakovës mund të them se ne jemi takuar me kryetarin e Gjakovës vitin e kaluar, kemi diskutuar dhe ka ardhur deri te ajo që të kemi një bashkëpunim më të ngushtë, sepse siç e dini AKM - ja nuk është marrë me to për shtatë vjet. Ne kemi thënë, do të merremi me këto ndërmarrje, jemi në monitorim e sipër, e bëjmë auditimin e jashtëm, monitorimin e brendshëm, auditimi i jashtëm dhe është vlersimi i investimeve, çka do të thotë se janë tri elemente pas këtyre elementeve. Ne e shohim se ku ka arritur me zotim, me premtimin që ka dhënë edhe për punësim, edhe për kryerjen e obligimeve të tjera. Pyetja tjetër, që ka të bëjë me listat e punëtorëve, rreth 7 vjet AKM - ja i ka pasur vetëm tre punëtorë, të cilët janë marrë me listat e punëtorëve. Ne tani i kemi 12 persona, kemi pritur 9 muaj që ICO - ja për ta emëruar një listë dhe kanë thënë se nuk ka nevojë. Mirëpo Pakoja e Ahtisarit e parasheh se ne listën e shqyrtimeve duhet të jetë një ndërkombëtar dhe ka të bëjë me Konventën e Vjenës lidhur me të drejtat e njeriut dhe është Komisioni i cili është i përbërë edhe nga një minoritar, një serb dhe një shqiptar dhe një ndërkombëtar. Te listat e punëtorëve, duhet të kuptohet, ka pasur ngecje të madhe dhe tani është shpejtuar si proces. Mirëpo, prapë presim vendimin final të Odës së Veçantë.

Pas debatit të gjerë Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti vjetor i Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2009

dhe paraqet këtë

Rekomandim

4. Shqyrtimi i Raportit vjetor i Zyrës së Rregullatorit për Energji – ZRRE për vitin 2009

Kryetarja – Theksoi se është ftuar kryetari i Bordit të ZRRE- së z. Ali Hamiti që të raportojë para Komisionit për Raportin vjetor të ZRRE - së për vitin 2009.

Ali Hamiti (kryetari i Bordit të ZRRE -së) – Theksoi se sipas ligjit dhe në kohën e duhur është dorëzuar Raporti vjetor për vitin kalendarik 2009. Këtu relativisht është dhënë gjerësisht arsyeja pse është kështu. Që prej 2001 - 2010 është një dhjetëvjeçar dhe kemi futur analizat dhe të dhënat e dhjetëvjeçarit të rrjedhave të energjisë dhe të aktiviteteve të energjisë. Për këtë arsye është pak më voluminoz. Ato janë të dhëna prej një Agjencie të pavarur që janë krejtësisht të besueshme dhe të analizuara paanësisht. Jemi përpjekur që ato detyra t'i kryejmë vërtet ashtu siç duhet t'i kryej një rregullator, pa ndikime të jashtme, por me profesionalizëm maksimalisht të lartë, për aq sa edhe i kemi kapacitetet. Edhe për të licencuarit, edhe për konsumatorët, edhe për industrinë, si dhe për ligjet janë observimet tona të paraqitura në këtë raport.

Kryetarja ua dha fjalën deputetëve për të shtruar pyetje rreth këtij Raporti.

Ethem Çeku – Theksoi se e përgëzon ZRRE- në për Raportin e mirë, sepse kemi një raport dhjetëvjeçar. Çështja e parë që pyeti ishte ajo për blerjet e energjisë në vitin 2009, çmimi dhe realizimi. Çështja e dytë është çështja e humbjeve teknike dhe e humbjeve komerciale dhe çështja e tretë është “Kosova e Re”, shifrat herë 500 e herë 200 e herë 1000 MW. Më intereson pikërisht për vitin 2015, e keni shkurtuar për 2 (dy) vjet Kosovën A, shtoi Çeku, ndërsa në Raport është që të realizohet deri në vitin 2015. Pastaj periudha afatmesme deri në ndërtimin e blloqeve, cilat janë ato politika të parapara?

Qamile Morina – Theksoi se ka vërejtur në Raport që mungojnë disa shënime që ndikojnë në miratimin e caktimit të tarifave me pakicë dhe humbjet komerciale sipas distrikteve. Sipas distrikteve të vitit 2009 ose vitin 2010, mungojnë në këtë raport. Pastaj tjetra, është raporti i humbjeve totale në Kosovë dhe në rajon për periudhën 2000-2010, d.m.th. është raport total. Tani, pasqyra, shkalla e ndikimit të investimeve, sa kanë ndikim investimet kapitale në zvogëlimin e humbjeve teknike në operatorin shpërndarës dhe në operatorin e transmissioinit. Pasqyra e shkallëve, shkalla e ndikimit të rritjes së konsumit, në rritjen e humbjeve teknike të operatorit shpërndarës. Do të thotë, a është konsumi apo investimet ato që ndikojnë më shumë në humbjet e operatorit shpërndarës? Vërejtja tjetër është se nuk ka zberthim të përafërt të importit për shkak të pikut ose për shkak të remontit. Po ashtu shtoj se këtu është tabela për shkëmbime, eksporti dhe importi i energjisë elektrike dhe vërehet së tre muajt e parë është jashtëzakonisht një çmim i lartë i importit të rrymës dhe kërkoj sqarim pse kjo ka ndodhur, sepse janë diku rreth 46 milionë euro, dikush duhet të japë përgjegjësi. Në Raport gjithashtu mungon paraqitja e ideve ose kërkesave të Zyrës së Rregullatorit, meqenëse humbjet janë të mëdha diku mbi 18%. Morina theksoj se kishte pritur që Raporti do të tregonte mënyrën si të veprohet që

çmimi i tarifave me pakicë të mos ketë ngritje dhe si Zyra e Rregullatorit mendon në këtë drejtim? Në fund shfaqti brengosjen që pse aktiviteti i Zyrës së Rregullatorit në Kosovë e ka emrin Zyra e Rregullatorit të UNMIK- ut, si anëtare rajoni? Zyra e Rregullatorit në Kosovë, përse duhet ende të figurojë si e tillë? Çka keni bërë ju që të ndryshohet? Janë tri vjet dhe cilat janë pengesat që ju nuk mund të jeni Zyra e Rregullatorit të Kosovës, por ende jeni e UNMIK - ut?

Zef Morina – Shtroi disa pyetje: tabela e furnizimit dhe eksportimit tregon se më shumë kemi marrë nga jashtë sa që Raporti në mes të vlerës së shitjes është diku rreth 20 apo rreth 50 %, sa ka qenë vërtet kostoja e 1 megavati të energjisë së importuar? Nga ana tjetër konsumatorëve iu shitet pothuajse me çmimin e njëjtë, mos edhe më shumë, kjo nuk është në rregull, sqaroi Morina. Po ashtu shtoi se nëse e shikojmë, kur kemi marrë vendim për ngritjen e tarifave, nuk ka qenë deri në 200 kilovat, por ka qenë prej 200 deri në 600 kilovat. Dhe ne e kemi diskutuar që nuk ka shtëpi, nëse i ka 3 drita që nuk i shpenzon 200 kilovat brenda muajit dhe gjatë verës askush nuk e përdor nxehjen dhe është më shtrenjtë së në Zvicër. Domethënë e keni ndryshuar politikën, që ne, si Komision, e kemi dhënë dhe kjo nuk është në rregull, tha Morina.

Ali Hamiti - Ajo është rregullore që nuk e përcaktojmë ne, është çështje metodologjie. Ajo ka shkuar në diskutim publik dhe është vendosur në një nivel shumë të lartë, se a të bëhet me blloqe apo të bëhet vetëm një tarifë?

Zef Morina – Ata që e paguajnë rrymën, edhe më i varfëri është duke e paguar rrymën më shtrenjtë sesa jemi duke e blerë. Nëse e nxjerrim mesataren se sa kemi import dhe sa prodhojmë vetë, më shumë jemi ne duke e paguar rrymën, se që është çmimi real dhe që duhet të paguhet. Kjo është vërejtje që më ka shqetësuar.

Kryetarja – Përgëzoj ZRRE - në për Raportin dhe shtoi se është njëra ndër Agjencitë e pavarura, që raporton me kohë dhe sjell raportin me kohë në Kuvend, në bazë të Kushtetutës. Në rast se e merr këtë material, të cilin e sjell Zyra e Rregullatorit dhe të dhënat shumë kontradiktore të KEK - ut , të jep për të kuptuar se definitivisht edhe fjalimi i Zef Morinës është shumë me vend. Qytetarët e Kosovës janë pre e shumë abuzimeve që bëhen. Furnizimi i konsumatorëve me energji elektrike, sipas planit A,B,C, por kjo është duke ndodhur në KEK dhe ju, si Zyra e Rregullatorit, jeni i detyruar që të raportoni. Pastaj nën 2, humbjet e energjisë janë marramendëse, por prapëseprapë këtu e mëson më së miri gjendjen se si e kemi në vitin 2009, një gjendje shumë e keqe, sidomos në Mitrovicë dhe në Gjakovë. Shihet ka rritje të faturimit në Prishtinë dhe Prizren, ndërsa në vendet e tjera, jo. Tregu i energjisë është e kuptueshme, se në treg kur të dalësh për të marrë atëherë kur nuk ke kontrata të planifikuara, KEK - u, duke marrë parasysh që blloqet e A- së janë shumë të vjetra dhe blloqet e B- së duhet të hyjnë në remont, duhet të japë raport se me çfarë çmime të energjisë do të furnizohemi ne, si qytetarë të Kosovës. Ndërsa subvencionimi për import të energjisë, vetëm tri vjet, sa jam unë këtu deputete prej 2007-2009, është diku 142 milionë e 97 mijë, që do të thotë është absurd të jepen tërë këto të holla vetëm për import të energjisë. Nuk dihet se KEK - u a i jep llogari ndonjëherë këtij Kuvendi apo Ministria e Ekonomisë dhe Financave ta tregojë realitetin se kah po shkojnë këto para? Dhe sektori i ngrohjes qendrore, duke e marrë parasysh

ligjin për ndërmarrjet publike, ku ngrohja e Prishtinës atakohet drejtpërdrejt me komunën e Prishtinës. Bëri apel prej mbledhjes së Komisionit që të hiqet përdorimi i mazutit, sepse siç po shihet, as nuk janë kah mund t'i mbledhin ata tarifën e konsumatorëve, por njëkohësisht as nuk po kemi para për të dhënë për blerjen e mazutit, duke e parë lëvizjen e çmimit në bursat e Amsterdemit, është absurde. Ne jemi vend shumë i varfër, por dhe qytetarët nuk mund ta përballojnë këtë gjë dhe duhet t'i ndërrohet destinimi drejtpërdrejt i ngrohjes me mazut, në ngrohjen me diçka tjetër. Ankesat, të cilat janë paraqitur te ju dhe prej ankesave i keni zgjidhur 142, ndërsa të pazgjidhura janë 176, shpresoj që do të zgjidhen deri në fund të vitit. Perspektivat e sektorit të gazit në Kosovë, këtu nuk do të hyjnë, sepse me infrastrukturë ligjore janë plotësuar dhe aktivitetet ndërkombëtare të Zyrës së Rregullatorit, duke marrë parasysh se ju jeni rregullator i cili duhet të punojë në mënyrë të pavarur dhe rregullator tek i cili duhet të vijë të gjithë investitorët, shpresoj dhe besoj shumë që ju do të punoni në vija edhe më të mira se këto. Aktiviteti juaj me ndërkombëtarët është pasqyruar në mënyrë shumë të duhur. Ndërsa çështja e heqjes së UNMIK-ut, të gjitha marrëveshjet të cilat janë bërë, Qeveria duhet të marrë vendim që të gjitha marrëveshjet që janë nënshkruar në kohën e UNMIK-ut të kthehen në marrëveshje me Republikën e Kosovës pas 17 shkurtit 2008.

Ali Hamiti – U përgjigj në pyetjet dhe shqetësimet e deputetëve, si në vijim: dikush energjinë e shpenzuar duhet ta paguajë, ajo sipërfaqe A ose B, dikush ka për ta paguar. A e paguajnë ata të parët, a të tjerët, ai katrorë, ajo njësi duhet të lëvrohet dhe të mbushet d.m.th. ajo sipërfaqe, a e patëm tek 200 - shi MW, a e nxorëm mesataren, e kemi dhe një mesatare për ta tërhequr një vijë mesatare. I heqim blloqet dhe del një mesatare e atij çmimi dhe njësoj prapë del ajo, aq energji, aq para duhet konsumatorët e amvisorisë t'i paguajnë. Blloqet janë definuar ashtu dhe ishte ideja se 200 - shi MW është me të vërtetë për nevojat fillestare. Kush nuk nxeht fare me energji elektrike? Nevojat për frigorifer, për kompjuter, për drita, është standard botëror, pak më i lartë se standardi botëror, por që quhet minimumi jetësor; tjetri është i pari deri në 600 MW, mesatarja deri në 600 MW, mesatarja e shpenzimit në amvisërinë kosovare është 600 MW. Kur ta pjesëtoni krejt energjinë dhe e ndani për konsumator, del 600 kilovat orë; vjet, në 2009-tën, Qeveria edhe Parlamenti e kanë aprovuar atë buxhet dhe i kanë dhënë 67 milionë euro, nuk janë shpenzuar të gjitha, sepse ndërkohë është liruar energjia në treg dhe kanë tepruar diku 10 milionë, të cilat ditën e fundit të vitit të kaluar Ministria e Financave që të mos dalë shumë suficit ia ka dhënë KEK-ut edhe ato 10 milionë iu kanë shtuar zërit buxhetor për KEK-un për import, që ka qenë 40 milionë dhe është bërë plus 10, është 50 milionë euro. Tarifën sivjet janë llogaritur me 50 milionë euro subvencion prej Qeverisë, andaj kanë dalë ashtu siç kanë dalë dhe nuk kam dashur t'i shtrenjtojë, dua të them nuk ka pasur bazë e jo që nuk kam dashur; humbjet teknike dhe komerciale është çështje shumë e rëndësishme të cilën jemi munduar edhe ju sa keni qenë kemi bërë task – force Çeku, krejt jemi munduar, as nuk ka bërë asgjë UNMIK-u, as kosovarët, as Qeveria, as OJQ- të e as askush hiç, sepse nuk kanë mundur, meqenëse dikush kyçet 5 herë dhe nuk shkon në gjyq e nuk dënohet për atë që e vjedh energjinë, që zihet duke e vjedhur dhe që e vjedh përsëri. KEK-u nuk ka arritur për të investuar shumë në distribucion dhe humbjet teknike pa investuar në tela e në nënstacione nuk dihen. Prishtina është e koncentruar dhe i ka punët më mirë, sepse ka popullatë të madhe që punojnë dhe janë më të rregullt, që paguajnë, janë humbjet më të vogla, sepse rrjeti është më i fortë etj. Mitrovica është e

veçantë, këtë e dini edhe ju, absolutisht unë nuk kam pse t'ju shpjegoj, që furnizohet edhe Veriu i Mitrovicës dhe ata nuk paguajnë. Ne, më shumë se çdo kush tjetër, kemi dëshirë që të quhemi Rregullator i Kosovës e të mos figurojë si UNMIK, por nuk është në forcën tonë. Ne brenda i kemi ndërruar të gjitha ligjet dhe aty ku shkruan UNMIK tani shkruan Qeveria e Kosovës.

Pas debatit të gjerë Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti vjetor i Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2009

dhe parashtrohet këtë

Rekomandim

Kuvendi i Kosovës të miratojë Raportin vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2009

5. Shqyrtimi i Projektligjit për Inspektoratin e Tregut dhe Mbikëqyrjen Inspektuese nr. L-181

Kryetarja ia dha fjalën kryesues së Grupit punues për shqyrtimi i Projektligjit për Inspektoratin e Tregut dhe Mbikëqyrjen Inspektuese nr. L-181, Nerxhivane Dauti.

Nerxhivane Dauti – Theksoi se Grupi punues gjatë shqyrtimit të tij ka hasur në disa çështje që i paraqet para Komisionit për diskutim disa vërejtje parimore, si në vijim: Projektligji ka përcaktuar funksionim e centralizuar vetëm në ministri d.m.th. në nivel qendror; nuk ka parashikime se si do organizohet dhe funksionojë në nivel lokal Inspektoriati edhe pse numri i komunave është me shtatë qendra mbi 35; organizimi, funksionimi, detyrat dhe përgjegjësit i janë lënë ministrit për t'i rregulluar me akt nënligjor. Institucioni nuk emërtohet se është departament apo agjenci; detyrat organizative janë të koncentruara vetëm në Drejtorinë; vendimet lëshohen nga drejtori e shpeshherë edhe nga inspektori dhe ka paqartësi për cilat raste nënshkruan.

Pas debatit Komisioni njëzëri nxori këtë

Konkluzion

Grupi punues të vazhdojë punën për amendamentimin e Projektligjit për Inspektoratin e Tregut dhe Mbikëqyrjen Inspektuese nr. L-181

6. Të ndryshme

I) Iniciativa për hartimin i Ligjit për Privatizim

Kryetarja kërkoj që të formohet Grupi punues për hartimin e Projektligjit për Privatizim.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

Konkluzion

Formohet Grupi punues për hartimin e Projektligjit për Privatizim në këtë përbërje: Myzejene Selmani, Ethem Çeku, Murselj Hajlilji, Kaqusha Jashari dhe Zef Morina.

II) Mbledhja e radhës

Kryetarja – Propozoi që në mbledhjen e radhës të shqyrtohen Raporti i KPPM - së dhe Raporti i KKK - së, dhe të miratohet Raporti i Projektligjit për miniera dhe minerale nr. L-163.

Pas debatit Komisioni e nxori këtë

Konkluzion

Në mbledhjen e radhës të shqyrtohen 1. Raporti i KPPM - së, 2. Raporti i KKK - së dhe 3. Të miratohet Raporti i Projektligjit të minierave dhe të mineraleve nr. L-163.

Mbledhja përfundoi në orën 13: 40.

E përgatiti:

Njësia e Mbështetjes së Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Myzejene Selmani